Nr. 768/7 Prot Tiranë, më 24.02.2025

Lënda: Dërgohet Raporti Përfundimtar dhe Rekomandimet për auditimin e performancës me temë "*Inspektoratet e vendit në mbrojtje të interesave publike*".

Drejtuar: INSPEKTORATIT QENDROR

TIRANË

Nga auditimi i ushtruar në Inspektoratin Qendror, në bazë të Programit të Auditimit nr. 768/2 prot., datë 01.10.2024, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit me objekt "*Inspektoratet e vendit në mbrojtje të interesave publike*", për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2021 deri më datën 31.12.2023, rezultoi se, Inspektoratet shtetërore nuk kanë siguruar përputhshmëri midis programeve mujore të inspektimit shkresor me atë elektronik; nuk janë respektuar kriteret e arsimimit të miratuara për punësimin e inspektorëve dhe janë kryer inspektime jashtë portalit "e – inspektimi" etj. të cilat nuk janë në përputhje me orientimet bashkërenduese e metodologjike të miratuara Bazuar në nenet 6, 15, 25 dhe 30 të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", si dhe në Vendimin nr. 28 datë 11.02.2025, të Kryetarit të KLSH-së", për përmirësimin e gjendjes, ju rekomandojmë zbatimin e masave të mëposhtme:

Pyetja kryesore: **A ka garantuar legjislacioni në fuqi funksionimin e duhur të inspektimit, në mbrojtje të interesit publik dhe interesave të ligjshëm të personave fizikë dhe juridikë?**

MESAZHI I AUDITIMIT

Inspektorati Qendror, në cilësinë e institucionit përgjegjës për bashkërendimin e veprimtarisë inspektuese, ka ushtruar kompetencat e veta për të bashkërenduar inspektimet dhe mbikëqyrur ligjin e inspektimeve, si dhe ka miratuar kriteret për arsimimin e inspektorëve dhe rregulla e udhëzime të tjera metodologjike në këtë fushë.
Inspektoratet shtetërore nuk kanë siguruar përputhshmëri midis programeve mujore të inspektimit shkresor me atë elektronik; nuk janë respektuar kriteret e arsimimit të miratuara për punësimin e inspektorëve dhe janë kryer inspektime jashtë portalit "e – inspektimi", etj. jo në përputhje me orientimet bashkërenduese e metodologjike të miratuara.
Për shkak të problematikave të bazës ligjore, ka pasur mbivendosje kompetencash e inspektimesh nga më shumë se një inspektorat, në veçanti në fushën e mjedisit midis AKM dhe IKMT – së.
Për të garantuar mbrojtje të interesit publik dhe interesave të tjerë të ligjshëm të personave fizikë dhe juridikë është miratuar ligji nr. 99, datë 12.09.2024 "*Për*

tonë janë rregulluar me ligjin nr. 10433, datë 16.06.2011 " Për inspektimin në RSH", i cili përcakton parimet e përgjithshme të inspektimit, organizimin e institucioneve publike që kryejnë funksione inspektimi, statusin e inspektorëve, rregullat e procedimit administrativ të inspektimit dhe krijimin e funksionet e Inspektoratit Qendror. Ky ligj, i cili nuk ka qenë i përafruar me acquis e BE – së, përcakton funksionet e inspektimit në juridiksionin e pushtetit ekzekutiv të qeverisjes qendrore. Këto funksione kryhen nga inspektoratet shtetërore, që janë institucione qendrore publike, në varësinë e një ministri përgjegjës, ku një inspektorat shtetëror është përgjegjës për të gjitha funksionet e inspektimit në fushën shtetërore të veprimtarisë së një ministrie. Organizimi i inspektorateve vendore bëhet sipas dispozitave të ligjit për vetëqeverisjen vendore[1], ndërsa procedurat e inspektimit të inspektorateve vendore rregullohen sipas ligjit për inspektimin dhe metodologjitë e hartuara dhe miratuara nga Inspektorati qendror. Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 99/2024 "Për Inspektimin e Republikën e Shqipërisë" në maj të vitit 2025, funksionet e inspektimit do të rregullohen sipas dispozitave të tij.

2. Gjetje nga auditimit: Ligji nr. 10433/2011, datë 16.06.2011 " Për inspektimin në RSH", ngarkon Inspektoratin Qendror me detyrën e bashkërendimit të veprimtarisë inspektuese midis nivelit qendror dhe atij vendor[2], por pa i siguruar mjetet për të kryer këtë proces. Sipas këtij ligji, IQ në drejtim të inspektorateve vendore ka vetëm këto kompetenca: miraton kërkesat specifike për arsimimin e inspektorëve në inspektoratet shtetërore dhe vendore; mban listën e përditësuar të inspektorëve në detyrë për çdo inspektorat shtetëror dhe vendor dhe e publikon atë në faqen zyrtare të internetit[3]; inspektorët shtetërorë dhe vendorë u nënshtrohen trajnimit të detyrueshëm dhe testimit profesional fillestar përpara konfirmimit në përfundim të periudhës së provës dhe testimit periodik. Po kështu, VKM nr. 696, datë 16.08.2013 "Për përcaktimin e procedurave të ushtrimit të kompetencave të Inspektoratit Qendror dhe të rregullave për përmbajtjen dhe administrimin e portalit unik "e - Inspektimi" nuk ka përfshirë inspektoratet vendore si përdorues të këtij sistemi duke u kufizuar vetëm tek inspektoratet shtetërore. Megjithatë, inspektorët vendorë janë trajnuar në kuadër të trajnimit të detyrueshëm edhe për përdorimin e këtij sistemi. Kjo situatë, me miratimin e ligjit nr. 99/2024, ka ndryshuar duke i dhënë IQ – së kompetenca të plota përfshirë këtu edhe përdorimin e sistemit "e – Inspektimi" nga ana e inspektorateve vendore.

3. Gjetje nga auditimi: Ligji nr. 10433/2011, datë 16.06.2011 " Për inspektimin në RSH" ka gjetur zbatim për një periudhë të gjatë kohore, duke konsoliduar funksionin e inspektimit në vendin tonë e duke justifikuar njëkohësisht nevojën inspektime, megjithatë implementimi i tij është shoqëruar me sfida të ndryshme. Në raportin paraprak mbi situatën e Inspektorateve Shtetërore në Shqipëri (Maj 2023), evidentohet pikërisht se kuadri ligjor dhe kapacitetet institucionale paraqesin sfida e problematika. Sipas këtij raporti, kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, përfshirë dhe ai sektorial, lidhur me inspektimet nuk është "*business friendly*", pra i kuptueshëm me lehtësi apo i thjeshtë në aplikim, duke u transformuar kështu në barrë administrative për bizneset. Në disa raste

4. Gjetje nga auditimi: Ligji i ri per inspektimin esnte nje ligj qe ka per objekt përcaktimin e parimeve të përgjithshme të inspektimit, unifikimin e veprimtarisë së inspektimit, në nivel qendror dhe vendor, përcaktimin e funksioneve, rregullave dhe procedurave që zbatohen gjatë ushtrimit të veprimtarisë së inspektimit, si dhe marrëdhënien e punësimit, rekrutimit, trajnimit dhe ecurisë në karrierë të inspektorëve. Nëpërmjet miratimit të tij kanë ndryshuar disa aspekte thelbësore të funksioneve inspektuese në vendin tonë. Këto ndryshme kanë të bëjnë me: krijimin e Bordit të inspektimeve; uniformimin e marrëdhënieve të punësimit; krijimin e Komisionit të rekrutimit dhe ecurisë në karrierë; përbërjen dhe funksionimin e komisioneve disiplinore; si dhe përbërjen dhe funksionimin e Komisioneve të shqyrtimit të ankimit pranë Inspektoratit të Përgjithshëm dhe NJVQV – ve. Pavarësisht këtyre risive, në vijim të këtij ligji, parashikohet që të hartohen dhe miratohen rreth 15 akte nën ligjore të tjerë.

5. Gjetje nga auditimi: Ligji i ri për inspektimet nr. 99, datë 12.09.2024 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", sa i përket vlerësimit të shkallës së përafrimit me legjislacionin e BE – së, sikurse edhe ligji nr. nr. 10433/201, është hartuar pa konsideruar përafrimin e tij me acquis communautaire. Gjithashtu, ai nuk është dërguar për komente pranë Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, sikurse parashikohet në Manualin për hartimin e ligjeve ku thuhet se projektligjet duhen dërguar edhe në Ministrinë e Integrimit, e cila ka detyrimin që të vlerësojë përputhshmërinë e tyre me acquis-në e BE-së. Po kështu, referuar manualit të hartimit të ligjeve, Udhëzimit të Ministrit të Drejtësisë dhe Rregullores së Këshillit të Ministrave, hartuesit e ligjit nuk kanë siguruar respektimin e hierarkisë ligjore, si dhe nuk kanë marrë parasysh përafrimin me acquis-në e BE-së.[5] Në kushtet kur, në vijim të hyrjes së këtij akti në fuqi, parashikohen që të miratohen akte të tjerë nën ligjorë për të plotësuar kuadrin e përgjithshëm, është thelbësor vlerësimi rast pas rasti i shkallës së përafrimit me legjislacionin e BE – së.

5.1 Rekomandim: Inspektorati Qendror, i cili do të riemërtohet Inspektorat i Përgjithshëm me ndryshimet ligjore, në procesin e dhënies së mendimeve për aktet nën ligjore që do të hartohen dhe miratohen për të vënë në zbatim ligjin nr. 99/2024 në kontekstin e riorganizimit të funksioneve inspektuese në rang vendi, të monitorojë dhe raportojë në vijimësi shkallën e përafrimit me legjislacionin e BE – së për këto akte.

Në vijimësi

2. A e ka përmbushur misionin e tij Inspektorati Qendror në përputhje me kuadrin ligjor?

1. Gjetje nga auditimi: Inspektorati Qendror ushtron aktivitetin bashkërendues në fushën e inspektimit, por inspektoratet shtetërore nuk sigurojnë përputhshmëri midis programit mujor të inspektimit shkresor me atë elektronik. Vërehet se, përgjithësisht programimi i veprimtarisë inspektuese nga inspektoratet shtetërore nuk është zbatuar në përputhje me programin fillestar të dërguar në IQ për mendim këshillimor, pasi është evidentuar një numër i lartë inspektimesh të paprogramuara. Më konkretisht vlerat totale të inspektimeve të realizuara pa mendim këshillimor nga inspektoratet shtetërore duke

	2021	2022	2023
ISHMT	391	482	173
AKM	0	0	186
AKU	0	2790	907
IKMT	0	108	12
ISHTI	115	108	197
ISHPSHSH	0	1230	661
DSHPA	63	108	277
TOTAL	**569**	**4826**	**2413**

Burimi: IQ, Përpunoi: GA

Nga ana e tij, Inspektorati Qendror në raportet e përgjithshme të inspektimit apo edhe në raportet e mbikëqyrjes specifike për inspektoratet shtetërore gjithmonë ka rekomanduar që të ketë përputhje të plotë midis programit shkresor dhe atij të hedhur në sistemin elektronik nga ISH – të, për të shmangur devijime të panevojshme në zbatimin e programit mujor të inspektimit.

1.1 Rekomandim: Inspektorati Qendror (i cili do të riemërtohet Inspektorat i Përgjithshëm), në kuadër të rishikimit të bazës nën ligjore që do të rregullojë sistemin "e – Inspektimi", brenda kompetencave që i janë caktuar nga ligji i ri për inspektimet nr. 99/2024, të parashikojë dispozita specifike në garantim të përputhshmërisë së plotë midis programeve mujore të inspektimeve shkresore dhe elektronike.

Brenda datës 31.12.2025

2. Gjetje nga auditimi: Gjatë auditimit është konstatuar se, Inspektorati Qendror ka hartuar dhe miratuar metodologjitë dhe rregullat për ushtrimin e funksioneve inspektuese, por nuk ka përditësuar Manualin e Përgjithshëm të Inspektimit që nga miratimi i tij në vitin 2015. Sipas parashikimeve të vet Manualit, Inspektorati Qendror bashkëpunon me inspektoratet shtetërore dhe vendore dhe bën rishikimin dhe përditësimin e këtij manuali. Ky hap është i rëndësishëm pasi siguron që, metodologjia dhe procedurat e inspektimit të mbeten në pajtueshmëri me praktikat më të mira dhe të pasqyrojnë ndryshimet në kuadrin ligjor dhe atë të inspektimit.

2.1 Rekomandim: Inspektorati Qendror (i cili do të riemërtohet Inspektorat i Përgjithshëm), të rishikojë Manualin e Përgjithshëm të Inspektimeve në kuadër të ndryshimeve të reja ligjore, për sigurimin e ushtrimit të funksioneve inspektuese, duke ju referuar edhe praktikave më të mira në këtë fushë.

Brenda datës 31.12.2025

3. Gjetje nga auditimi: Për periudhën objekt auditimi, inspektoratet shtetërore nuk kanë respektuar gjithmonë kriteret e arsimimit për pozicionet e punës "inspektor", sipas miratimeve të Inspektoratit Qendror. Sipas ligjit nr. 10433/2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", Inspektorati Qendror nuk ka kompetenca të drejtë për drejta në

nëpunësit civil. Pavaresisht kritereve të miratuara, për pozicionin e punës "Inspektor", janë gjetur raste të mos përmbushjes së kriterit të arsimimit në përputhje me aktin e miratuar nga Inspektorati Qendror, gjë e cila ka sjellë si pasojë mos marrjen pjesë në procesin e testimit fillestar në periudhë prove. Më konkretisht, për periudhën 2021 - 2023 janë evidentuar mospërputhje specifike si vijon[6]: 6 raste (nga 89 inspektor gjithsej) në Inspektoratin Shtetëror Teknik Industrial; 5 raste (nga 245 inspektor gjithsej) në Inspektoratin Shtetëror Shëndetësor; 22 raste (nga 506 inspektor gjithsej) në Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit; 9 raste (nga 337 inspektor gjithsej) në Autoritetin Kombëtar të Ushqimit.

3.1 Rekomandim: Inspektorati Qendror (i cili do të riemërtohet Inspektorat i Përgjithshëm) në kuadër të rikonceptimit të funksioneve inspektuese me hyrjen në fuqi të ligjit të ri nr. 99/2024, të kryejë një vlerësim paraprak në lidhje me kriteret e arsimimit për trupën inspektuese sipas fushave të inspektimit, duke pasur parasysh që pranë këtij institucioni do të ngrihet dhe funksionojë Komisioni i rekrutimit dhe ecurisë në karrierë.

Brenda datës 31.12.2025

3 A i kanë ushtruar kompetencat e tyre sipas akteve ligjore dhe nënligjore inspektoratet shtetërore dhe vendore?

1. Gjetje nga auditimi Përgjithësisht, bazuar në raportet e mbikëqyrjes së zbatimit të ligjit, inspektoratet shtetërore, gjatë kryerjes së funksioneve inspektuese kanë pasur problematika të ndryshme që lidhen me mungesën e dokumentacionit apo të dhënave të ndryshme të inspektimeve; mospërputhje në të dhënat e inspektimeve; shkelje të procedurave ligjore gjatë kryerjes se procesit të inspektimit si proces administrativ; mosrespektim të afateve etj. Sipas këtyre të dhënave për vitin 2023, këto fenomene kryesore të përmbledhura në numër të përafërt rastesh kanë rezultuar si më poshtë:

Tabela 12 Përmbledhëse e tipologjisë së mangësive

Inspektorate[7]		Mungesë dokumentacioni/të dhënash	Mospërputhje në të dhëna	Shkelje të procedurave ligjore	Mosrespektimi i afateve.
1	AKBPM	+12	+6	+4	+8
2	AKSEM	+11	+16	+18	-
3	AKMC	+8	+2	+29	-
4	AKU	+103	+62	+246	+33
5	DSHPA	+26	-	+87	-
6	ISHSH	+20	+13	+224	+44
7	ISHMT	+15	-	+22	-
8	ZMR	3	-	-	-
9	ISHTI	+8	+6	+51	+6
10	AKM	+25	+9	+31	+13
11	ISHPSHSH	+3	+11	+145	-

procesit të mbikëqyrjes që ushtrohet nga IQ.

1.1 Rekomandim: Inspektorati Qendror, i cili do të riemërtohet Inspektorat i Përgjithshëm të përmbledhë në një raport specifik të gjitha problematikat lidhur me zbatimin e procesit të inspektimit në përputhje me bazën ligjore ende në fuqi (ligji nr. 10433/2011), me qëllim korrigjimin e këtyre fenomeneve me rikonceptimin ligjor, nënligjor dhe rregullator të procesit të inspektimit që do të zhvillohet në zbatim të ligjit nr. 99/2024.

Brenda datës 30.04.2025

2. Gjetje nga auditimi: Gjatë auditimit janë evidentuar raste të mbivendosjes së veprimtarisë inspektuese, në veçanti midis inspektorateve në nivel qendror, për shkak të mbivendosjes së kompetencave në fusha të caktuara. Këto mbivendosje janë evidentuar nga Inspektorati Qendror gjatë mbikëqyrjes së veprimtarisë inspektuese, sidomos midis IKMT dhe AKM. Për fushat e inspektimit mjedis, pyje dhe ujëra është rritur barra administrative e biznesit, duke ndëshkuar bizneset me masë administrative për të njëjtën shkelje nga më shumë se një inspektorat. Pikërisht për këtë aspekt, bizneset i janë drejtuar shpesh herë me ankesa specifike institucioneve inspektuese, si edhe Inspektoratit Qendror. Sipas të dhënave[8] të vendosura në dispozicion nga Inspektorati Qendror të nxjerra nga sistemi "e – Inspektimi" për periudhën 2022 – 6 mujori i parë 2024[9] rezultojnë rastet si më poshtë:

Tabela 13 Rastet e inspektimit në fushën e mjedisit dhe ujëra nga AKM dhe IKMT

Numër subjektesh të inspektuara në fushën e mjedisit dhe ujërave nga AKM dhe IKMT	**2022**	**2023**	**6 Mujori 2024**
	149 subjekte	**132** subjekte	**51** subjekte

Burimi: IQ Përpunoi: GA

Ky fenomen nisur në vitin 2019, me ndryshimet e VKM - së nr. 502, datë 13.09.2017 "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Brendshme", që i ka është shtuar këtij institucioni në fushën e përgjegjësisë së vet edhe "*parandalimin, mbrojtjen, mbikëqyrjen dhe kontrollin e zbatimit të legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e tokës, ajrit, ujërave dhe pyjeve nga ndotje, dëmtime apo ndërhyrje të kundërligjshme të çfarëdo lloji.*[10]" Këto përgjegjësi të reja janë ushtruar nëpërmjet IKMT - së në cilësinë e institucionit të varësisë përgjegjës për funksionet e inspektimit. Me VKM nr. 604 datë 20.10.2021, "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë Shtetërore të Ministrisë së Brendshme", i cili ka shfuqizuar VKM – në e sipër cituar, *"parandalimi, mbrojtja, mbikëqyrja dhe kontrolli/inspektimi i zbatimit të legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e tokës/territorit, ajrit, ujërave dhe pyjeve nga ndotje, dëmtime apo ndërhyrje të kundërligjshme të çfarëdo lloji"* ka vijuar të mbetet në fushën e përgjegjësisë së Ministrisë së Brendshme. Pikërisht këto fusha kanë qenë më parë kompetencë ekskluzive e

ligjit nr. 99/2024, në procesin e dhënies së mendimeve për aktet ligjore ndër të cilat edhe këtë riorganizim, të orientojë me saktësi procesin vendimmarrës duke ndihmuar në ndarjen e duhur të kompetencave të inspektorateve shtetërore sipas fushave specifike inspektuese, duke patur një vëmendje të veçantë sa i takon eliminimit të mbivendosjeve midis IKMT – së dhe AKM - së.

Në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Inspektoratet në nivel vendor ushtrojnë aktivitetin e inspektimit pa mbikëqyrje nga Inspektorati Qendror. Sipas ligjit për vetëqeverisjen vendore, funksionet e inspektimit në nivel vendor krijohen apo përcaktohen me vendim të këshillit bashkiak të njësisë vendore përkatëse. Në këtë drejtim është evidentuar se, sa i takon mbikëqyrjes së zbatimit të ligjit për inspektimet dhe legjislacioneve specifike sektoriale, aktualisht Inspektorati Qendror nuk e ka tagrin ligjor për të kryer këtë proces pranë inspektorateve vendore. Me hyrjen në fuqi të ligjit të ri për inspektimet, kompetencat e Inspektoratit Qendror, i cili do të riorganizohet nën emërtimin Inspektorati i Përgjithshëm, janë zgjeruar dhe qartësuar në këtë drejtim, duke lejuar mbikëqyrje dhe bashkërendim të plotë.

3.1 Rekomandim: Inspektorati Qendror, i cili do të riemërtohet Inspektorat i Përgjithshëm, në kuadër të kompetencave të reja që i ka dhënë ligji nr. 99/2024, të marrë masa për të siguruar koordinim midis funksioneve inspektuese, të sigurojë mbikëqyrje të vazhdueshme për ligjshmërinë e veprimtarive inspektuese të inspektorateve vendore, duke patur si objektiv edhe shmangien e mbivendosjes së kompetencave me inspektoratet qendrore, duke siguruar orientim të qartë e të saktë në këtë drejtim.

Në vijimësi

Në zbatim të nenit 15, shkronja "j', të ligjit nr. 154/2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" për masat e marra nga ana Juaj të përgatiten programe me afate dhe persona përgjegjës dhe për zbatimin e rekomandimeve të njoftohet Kontrolli i Lartë i Shtetit brenda 20 ditëve nga marrja e kësaj kërkese.

Në vijim e në zbatim të nenit 30, pika 2 e këtij ligji, kërkohet ndjekja e realizimit të tyre në vazhdimësi duke nxjerrë aktet e nevojshme administrative dhe nisjen e procedurave disiplinore e administrative apo hartimin e padive gjyqësore për shpërblimin e demit dhe mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna, nga ana Juaj të raportohet (me shkrim) pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit brenda 6 muajve nga marrja e njoftimit të Raportit Përfundimtar të auditimit dhe rekomandimeve.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYETAR